

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E HËNË 11 PRILL 2022

Përshëndetje, e nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot është një ditë kur ne duhet të flasim për problemet e zgjedhësve, të cilët na kanë votuar dhe presin të përfaqësohen nga ne duke shprehur hallet dhe shqetësimet e tyre. Dua të ngre sot disa nga shqetësimet e banorëve të Bashkisë Divjakë, zonës që unë përfaqësoj. Dua ta nis me problemet e fermerëve, përherë aktuale e të vazhdueshme në Divjakë, si kudo në Shqipëri, që ato janë: plehrat kimike me çmime të trefishuara muajt e fundit, pa asnjë kontroll të cilësisë së tyre; pasiguria e tregut të shitjes; çmimet e ulëta, të cilat nuk mbulojnë as kostot e prodhimit, mungesa e subvencioneve për shumicën e fermerëve.

Po afron stina e thatësirave për bujqësinë dhe ju propagandoni kanalet kulluese dhe vaditëse, fonde që shpenzohen në emër të tyre, por realiteti është krejt ndryshe. Nuk ka as kanale kulluese, as vaditëse, nuk ka as vaditje me rrjedhje të lirë, që e propagandoni në rrjetet sociale, në fakt, janë vetëm pompat vaditëse që punojnë në çdo stinë në puse të hapura privatisht nga fermerët në arat e tyre. Do të ndalem, gjithashtu, në një problem shqetësues të banorëve të fshatit Sulzotaj, i denoncuar edhe në rrjetet sociale, të cilët prej më se një viti vuajnë për një rrugë hyrëse në fshat që të mos u rrezikohet jeta sa herë që kalojnë aty. Prej më se një viti gjendja e rrugës kryesore është në segmente të caktuara kështu.

Në fakt, dua të saktësoj se kjo nuk është një rrugë e mirëfilltë, por një shtresë asfalti mbi argjinaturën e lumit Shkumbin, dhe aktualisht e dëmtuar rëndë në disa segmente të saj, e prerë përgjysmë, ku mjetet jo vetëm që nuk mund të shkëmbehen, por rrezikojnë të rrëshqasin poshtë argjinaturës në rreth 3 metra lartësi. Ka pasur deri më tani mjaft aksidente, fatmirësisht jo fatale për jetën, por që problemi është mjaft i mprehtë. Banorët e fshatit Sulzotaj kërkojnë marrjen e masave sa më shpejt, që të mos vihet në rrezik jeta e tyre. E kemi denoncuar edhe në rrjetet sociale, por asnjë reagim nuk ka nga organet përgjegjëse, nga ato lokale, të cilat për respekt të këtyre banorëve duhet të kishin reaguar. Për me tepër ky fshat, në brendi, në një harresë 30-vjeçare, nuk ka thujse asnjë segment rrugor të asfaltuar dhe balta mbizotëron në 3 muajt e vitit me reshje.

Një tjetër problem shumë i mprehtë, në fakt, është problemi që lidhet me fokusin kryesor të propaganduar nga qeveria juaj. Ky është territori, mbetjet ku ju doni të jeni kampion në rajon e Europë, për incenerimin e mbetjeve. Unë do të doja sot të prezantoja vendgrumbullimin e mbetjeve në Bashkinë e Divjakës. Ky është një nga vendgrumbullimet e mbetjeve në bashkinë e Divjakës, them special, sepse, siç e shohim edhe nga pamjet ky vendgrumbullim gjendet buzë rrugës kryesore, pra është i lehtë depozitimi i mbetjeve nga mjetet e transportit të bashkisë, ndodhet në një vend të ngritur në relief në raport me tokat e fermerëve dhe me lagunën ku ujërat e ndotura lehtësisht rrjedhin mbi tokat e

fermerëve dhe mbi lagunë, e cila ndodhet vetëm 500 metra nga vendgrumbullimi i mbetjeve, në fshatin Gur të njësisë administrative Remas, për më tepër 200 metër më tutje janë banesa e fshatit.

Unë mendoj se nuk na duhen me tepër arsye për t'i vënë "kurorën" këtij vendgrumbullimi. Ministrja Kumbaro përmendi se unë jam shumë e re për ta ditur gjenezën, por, në fakt, janë 7 vjet ku ky vendgrumbullim pa asnjë leje mjedisore në një park të mbrojtur kombëtar, siç është parku i Divjakës, ekziston, zgjerohet dhe rritet nga viti në vit. Kjo falë Bashkisë së Divjakës, e cila asnjë lloj reagimi nuk ka pasur përtej të gjitha denoncimeve shqetësuese të banorëve të këtij fshati. Ju faleminderit!